



Data: 05 maj 2018

Buletin Informativ

Nr.1, 2018

Drejtori i DVP Kukës, Drejtues Zef LASKA, takon shefat e Seksioneve, SPZ-të, punonjësit e policisë Patrullës së Përgjithshme dhe Sektorin e Qarkullimit Rrugor si dhe prezantohet me gazetarët e qarkut.



Më datë 16.05.2018, Drejtori i DVP Kukës, Drejtues Zef LASKA, zhvilloi në zyrën e tij, një takim prezantimi me gazetarët e qarkut. Gjatë takimit, Drejtori i DVP Kukës bëri një prezantim të karrierës së tij policore. Gjithashtu, ai vuri theksin tek rëndësia e bashkëpunimit në mes Policisë dhe Medias, e cila është një urë lidhëse me qëllim informimin e komunitetit.

Më datë 28.05.2018, Drejtori i DVP Kukës, Drejtues Zef LASKA, në sallën e mbledhjes në DVP zhvilloi një takim me shefat e Seksioneve, SPZ-të, punonjësit e policisë të patrullës së Përgjithshme dhe Sektorin e Qarkullimit Rrugor. Gjatë takimit Drejtori u ndal në disa pika kryesore dhe kryesisht në:

-Rëndësinë që ka profesionalizmi dhe përkushtimi i çdo punonjësi policie për ti garantuar sigurinë e qytetarëve. -Në evidentimin e çdo automjeti që lëviz në orët e vona në qytet, në intervistimin, nëse është e mundur, dhe pyetjen e qytetarit nëse i duhet ndihma e policisë. Në drejtim të Qarkullimit Rrugor, Drejtori kërkoi më shumë punë nga ana e efektivit të qarkullimit rrugor, në lidhje me disiplinimin e parkimit dhe trafikut në qytet. Gjithashtu, ai nënvizoi se puna nuk matet me numrin e gjobave, por me sensibilizimin dhe edukimin e qytetarit për shkeljet e konstatuara.

Në drejtim të punës së SPZ-ve, Drejtori Vendor i Policisë u ndal në tre pika kryesore;

1. Siguria në shkollë. SPZ-të të fokusohen në sigurinë e shkollave 9- vjeçare apo të mesme, shqetësimi i çdo prindi dhe i Policisë, pasi pjesa më e madhe e punonjësve të policisë jemi prindër, është siguria e fëmijëve në shkollë, SPZ-të të mos kursejnë asgjë për sigurinë e fëmijëve dhe nëse ju duhet mbështetje e patrullës, qarkullimit rrugor, duhet ta kërkojnë në çdo moment. Të evidentohen problemet dhe të mbahen takime të rregullta me drejtuesit e shkollave apo mësuesit.

2. Çështja e konflikteve. SPZ që shkon i pari apo çdo punonjës policie duhet të shfaqë seriozitet, të vlerësojë dhe parandalojë konfliktin. Ti ofrojë qytetarit shërbimin më të mirë të mundshëm, dhe të mos neglizhojnë në asnjë çast!

Qytetari duhet të fitojë besimin tuaj.

3. Kanabisi. Zero kultivim në qarkun tonë- zero tolerancë kultivimit, ta shkatërrojmë që në fazat e para dhe të sigurojmë informacione në këtë drejtim.



Zhvillohet trajnimi i grupit të 1 të OPK-ve për DVP-në e Kukësit -Intervista.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve për policimin në komunitet të DVP Kukës si DVP e zgjedhur pilot, Programi Suedez "Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri" në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe DVP Kukës organizuan një trajnim 4 ditor me shefat e seksioneve të Policimit në Komunitet si dhe me Ndihmës Specialistë të Policimit në Komunitet të 3 komisariteve të D.V.P. Kukës. Ky trajnim u zhvillua në datat 28-31 maj 2018 në Kukës.

Botuar nga: Zyra për Komunikimin me Median dhe Publikun në D.V.P. Kukës:

Tel: +355 69 4115009

@kukes@gmail.com



Drejtorja Vendore Policisë kukes



Përveç temave teorike mbi Policimin në Komunitet të tilla si: Policimi në Komunitet si filozofi, paradigma e ndryshimit, sistemi dhe elementet e Policimit në Komunitet, u trajtuan në mënyre praktike tema siç ishin roli, detyrat dhe përgjegjësitë e SPK, parandalimi në rendin publik, veprimi pro-aktiv në vend të atij reagues, bashkëpunimi me qytetarët dhe aktorët e tjerë të komunitetit etj.

Pjesëmarrësit e vlerësuan angazhimin, eksperiencën e trajnuesve dhe metodologjinë e përdorur. Në muajt në vazhdim, e gjithë pjesa tjetër e Ndhmës Specialistëve të Policimit në Komunitet si dhe drejtuesve të tyre të DVP Kukës do trajnohen nga Programi.

Pjesëmarrësve iu bë një intervistë e shkurtër në grup dhe individualisht në lidhjen me trajnimin e zhvilluar:

- **Si u ndjetë gjatë trajnimit? A ishte interesant?**

Jemi ndjerë shumë mire në këtë trajnim si në aspekt të menaxhimit të tij, por çka është edhe më e rëndësishme për punën tone të përditshme kemi mësuar shumë, sidomos nga përvoja e ekspertëve të huaj. Ata ndanë me ne përvojën gjermane të policimit në komunitet dhe shpjegimi i kësaj filozofie të policimit na e bëri edhe më të qartë punën tone dhe se si ne mund ta menaxhojmë atë. Një risi ishte edhe metodologjia e përdorur nga trajnuesit, e cila e bënte shumë më të lehtë kalimin e njohurive të tyre tek ne.

- **Sa i vlefshëm është ky trajnim për ju, a mendoni se do jetë më pro-aktivë pas këtij trajnimi për të parandaluar ngjarjet?**

E quajmë një trajnim të vlefshëm sepse na përmbush qëllimet tona, metodat e policimit të tyre do na ndihmojnë në punën tonë të përditshme, Mendojmë se do jemi më afër komunitet për të parandaluar ngjarjet, duke hequr dhe disa detyra që mund të zgjidhen nga patrulla e përgjithshme, për të pasur më shumë kohë në shërbim të komunitetit. Ky trajnim e bën më të lehtë dhe të qartë punën dhe sjelljen e SPZ me komunitetin. Trajnimi na mësoi që roli i SPZ me komunitetin është rol miqësor shërbyes ndaj komunitetit dhe bashkëpunues, gjithashtu do na ndihmonte nëse na orientojnë drejt mënyrës së punës së një oficeri të vendit të tyre, në punën tonë.

- **A mendoni se eksperiencia e ekspertëve të huaj ju ndihmon për të parandaluar ngjarje?**

Modeli që u shfaq në trajnim ishte për një polici pro-aktive e pavarur, duke zbatuar vetëm ligjin. Mësuam teknikat e prezantimit në komunitet që do na ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve, duke u paraqitur pranë komunitetit me një performance sa më dinjitoze.

- **A mendoni se keni nevojë për trajnime të tjera të këtij formati?**

Patjetër që kemi nevojë dhe këto trajnime të jenë periodike, pasi shkëmbimi i ideve dhe diskutimi sesi ti zgjidhim mangësitë apo problemet, do na ndihmojnë në punën tone me qëllim që ti ofrojmë komunitetit shërbim sa më të shpejtë dhe cilësor.



Përfundon restrukturimi i DVP Kukës"

Sikurse jeni ne dijeni ka disa muaj që punohet për të projektuar strukturën e re në DVP Kukës, ashtu sikurse dhe në DVP-të e tjera të PSH. Që në fillim vlen të theksohet fakti se është pasur parasysh që implementimi i strukturës së re parashikon një rishpërndarje të burimeve njerëzore të drejtorisë dhe komisariateve të policisë së Kukësit sipas situatës së kriminalitetit dhe nevojave të komunitetit. Kjo nuk do të ketë efekte në humbjen e vendeve të punës, pasi shkurtimi i disa funksioneve organike në një strukturë do të shoqërohet me shtimin e funksioneve tek strukturat e tjera sipas nevojave. Si rezultat numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë nuk ndryshon.

Risi në këtë strukturë është krijimi i dy funksioneve zëvendësudrejtor, që lehtëson procesin e menaxhimit dhe drejtimit të shërbimeve policore. Gjithashtu në varësi të drejtpërdrejtë të drejtorit do të jetë dhe Sektori i Analizës, Planifikimit, Monitorimit dhe Vlerësimit. Roli i këtij sektori është grumbullimi i informacionit dhe përgatitja e një analize, për identifikimin, vlerësimin dhe priorizimin e risqeve. Ky Sektor do të përgatisë propozime afatshkurtra për vendimmarrje, në propozimet strategjike dhe operacionale afatmesme dhe afatgjata. Përveç kësaj, do të monitorojë dhe vlerësojë proceset e punës dhe rezultatit e ndikimit të shërbimit të ofruar nga strukturat e DVP. Ndërsa në Komisariatin e Policisë Kukës, Shefi i Komisarariatit të Policisë do të mbështetet nga një Zëvendës Shef Komisariatit, i cili do të ketë përgjegjësi dhe kompetenca të përcaktuara, si dhe të deleguara nga Shefi i Komisarariatit.

Në përberje të seksionit të policimit në komunitet do të jenë edhe 2 punonjës policie të specializuar dhe me integritet, si dhe me aftësi shumë të mira komunikuese dhe me aftësi për mësimdhënie.

